SPECIFIKIME TEKNIKE PER LODRAT

| Nr. rendor | Specifikime | Imazhi | *Njësia* | *Sasia* |
|---|---|---|---|---|
| 1 | ➢ **Loje e kompozuar me rreshkitese**<br><br>Struktura e lojes te jete e ndertuar me tuba celiku, me diameter 114 me trashesi 2.5mm. E lyer me veshje pudre poliesteri me cilesi te larte per perdorim ne natyre ,mbyllja e tubave ne pjesen e siperme duhet te jete me tapa te trasha 5mm material polipropileni , pjeset lidhese duhet te jene me material PP (polipropilen)<br>Platforma e sheshit te jete e ndertuar me flete hekuri 2mm trashesi dhe me profil 40x20x2mm<br>Pjesa e siperme dhe anesore e platformes duhet te jete e mbuluar me gome natyrale (plastisol) .<br>Shkallet duhet te jene metalike, dhe te veshura me gome natyrale (plastisol).<br>Rreshkiteset te jete me material (LLDPE) polietilen me dendesi te larte dhe me shtrese te dyfishte.<br>Bllokueset e sigurise duhet te jene material politilieni, kapja e te gjithe aksesoreve duhet te jete me rozete prej polipropileni.Te gjithe vidat te jene te mbuluara me tapa politilieni.<br>Lidhja e modulit me token te behet nepermejet nje baze metalike (ankerim) qe bashkohet me modulin nepermjet bulonave dhe me token me anen e betonimin |  | Copë | 4 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2 | ➢ **Lisharse ne forme A - Loje e kompozuar me dy lisharse**<br><br>Struktura e lojës të jetë e ndërtuar me strukture ne forme A me tuba celiku me diametër 89 mm dhe me trashësi 2 mm.Trau ku vendosen kolovajset duhet te jete me diameter 89 mm me trashesi 3mm. Suportet e koshave lishares do te jene të salduara me traun lidhes me dopio kushinetë. Veshja e tij duhet te jetë prej pudre poliesteri me cilësi të lartë për përdorim në natyrë dhe rezistent ndaj kushteve të ndryshueshme atmosferike.<br>Koshat e lisharsit duhet të jenë me barrierë për sigurinë e fëmijëve dhe në formë shporte. Për prodhimin e lisharsit përdoret material HDPP me densitet të ulët dhe i galvanizuar.<br>Zinxhiri është me trashësi 6 mm dhe I gavalnizuar.<br><br>Ankorimi I modulit me tokën bëhet nëpërmjet një baze metalike që bashkohet me modulin nëpërmjet bulonave dhe me tokën me anën e betonimin në këtë mënyrë bëhët me e rezistueshme dhe me solide.<br><br>Lëndët ngjyruese të përdorura do të jënë të përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe sipas rregullores ushqimore. | <br> | Copë | 6 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3 | ➢ **Loje e kompozuar me lekundes suste**<br><br>Loja duhet të jëtë me pllakë celiku me trashësi 5 mm për ankorim dhe sustë celiku me diametër 20 mm e temperuar. Pesha e produktit duhet të jetë min.15 kg.<br>Ndenjëset e lodrës janë të prodhuar me material CTP HDPE të përshtatshme për sigurinë e shëndetit të fëmijëve.<br>Ankorimi I modulit me tokën bëhet nëpërmjet një baze metalike që bashkohet me modulin nëpërmjet bulonave dhe me tokën me anën e betonimit. Në këtë mënyrë lodra bëhet më e rezistueshme dhe më solide gjë e cila garanton siguri të fëmijës gjatë qëndrimit në të.<br>Lëndët ngjyruese të përdorura do të jenë të përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe sipas rregullores ushqimore. |  | Copë | 5 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4 | ➢ **Loje e kompozuar me nje tra ekulibri**<br><br>Produkti do të formohet nga 3 shtylla të galvanizuara, ku 2 prej tyre do të kenë lartësinë 60 cm nga toka dhe shtylla që do vendoset në mesin e tyre do të jetë e gjatë 320 cm.<br>Materiali i shtyllave do të jetë i galvanizuar dhe i nënshtruar procesit të lyerjes në furrë.<br>Pjesa e ndenjësve ulëse duhet të jenë të prodhuara nga material polietileni me përmasa 40 x 20 x 25 cm dhe trashësia e shtyllave në formë tubi të jetë 90 mm.<br>Lëndët ngjyruese të përdorura do të jenë të përshtatshme për shëndetin e fëmijëve dhe sipas rregullores ushqimore.<br>Përmasat fikse janë në vizatimet bashkangjitur. |  | Copë | 6 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5 | ➢ **Gomine shtrim 40x40x2cm**<br><br>Gominat jane me permasa 40x40x2 cm.<br>Prodhohet duke aplikuar trajtim termik (150-180°C) dhe presion (200 bar) në presa gome sipas trashësisë së tyre dhe zierje për një kohë të caktuar.<br><br>Në prodhimin e gomave të derdhura, lidhësi një komponentësh me bazë poliuretani nuk duhet të jetë më pak se 5%. Në prodhimin e materialeve të gomës, pigmentet e oksidit të hekurit duhet të përdoren për ngjyrën e kuqe dhe pigmentet e oksidit të kromit për ngjyrën e gjelbër. Pesha mesatare prej 1 metër katror materiale gome modulare;<br><br>Jane te rezistueshme ndaj kushteve te ndryshme atmosferike.<br>Lejojne kullimin e ujit.<br>Jane 100% te riciklueshme.<br>Jane rezistente ndaj ngricave dhe kane efekt kundra rreshkitjes. |  | M2 | 167 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6 | ➢ **Rrotulluese plastik park**<br><br>Lodër rrotulluese siluete 75 cm e lartë me diameter 145 cm , e cila do të montohet në tokë e mbeshtetur ne bosht metalike me ane te gushinetave konike. Me 8 vende për fëmijë për tu ulur dhe peshë minimale 55 kg e përbërë nga material polietileni. Pjesët e ndenjeseve do të prodhohen me metodën e rrotullimit me min.21 cm gjerësi dhe 21 cm lartësi.<br>Do të ketë një timon rrotullues të përbërë nga material HDPE me diameter 29 cm dhe me trashesi 18 mm siç mund të shihet në vizatimin teknik i cili do të sigurojë lëvizjen rrotulluese të lodrës.<br>Lënda e parë që do të përdoret në prodhimin e tij është LLDPE (Linear Low-Density Polyethylene e cila do të jetë e përshtatshme për shendetin e fëmijëve dhe rregullores ushqimore. |  | Copë | 5 |